



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FEDERATA SHQIPTARE E KARATESË



RREGULLORE E BRENDSHME

PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN
E FEDERATËS SHQIPTARE TË
KARATESË

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Karatesë
Datë 12 Shkurt 2017

TABELA E LËNDËS

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
NENI 1. QËLLIMI I RREGULLORES	3
NENI 2. OBJEKTI I RREGULLORES.....	3
ORGANET E FEDERATËS.....	3
NENI 3. STRUKTURA ORGANIZATIVE	3
NENI 4. KOMISIONI TEKNIK.....	4
NENI 5. KOMISIONI I DISIPLINËS	6
NENI 6. KOMISIONI I GJYQTARISË.....	7
NENI 7. KOMISIONI I FINANCËS	8
NENI 8. KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË GARAVE	10
ANËTARËSIMET	11
NENI 9. ANËTARËSIMI	11
NENI 10. DETYRIMET E ANËTARËVE	11
NENI 11. LIBREZA E ANËTARIT.....	12
NENI 12. TRANSFERIMET	13
EKIPET KOMBËTARE.....	13
NENI 13. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË TRAJNERËVE TË EKIPIT KOMBËTAR	14
NENI 14. PËRZGJEDHJA E TRAJNERËVE	14
NENI 15. DETYRAT E TRAJNERIT TË EKIPIT KOMBËTAR.....	15
NENI 16. KRITERET E SPORTISTËVE TË EKIPIT KOMBËTAR.....	15
NENI 17. MASA E PËRFITIMIT DITOR DHE SHPËRBLIMET.....	16
AKTET ADMINISTRATIVE	16
NENI 18. AKTET ADMINISTRATIVE.....	16
NENI 19. NËNSHKRIMI	16
NENI 20. VULA	17
NENI 21. VËRTETIME DHE DOKUMENTA NGA FSHK	17
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT	18
NENI 22. SHFUQIZIM.....	18
NENI 23. HYRJA NË FUQI	18

Federata Shqiptare e Karatesë, me qëllim rritjen e shkallës së mirëfunksionimit dhe efektivitetit të veprimtarisë së saj, në përputhje me rregullat dhe parimet e Federatës Botërore të Karatesë, bazuar në Ligjin Nr. 9376 datë 21.04.2005 “*Për Sportin*” i ndryshuar, dhe në Statutin e saj miratuar me Urdhër Nr. 54, datë 25.02.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (në vijim “Statuti”),

V E N D O S I:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizmin dhe funksionimin e Federatës Shqiptare të Karatesë (këtu e në vijim “Federata”), të drejtat dhe detyrimet përkatëse të organeve administrative të saj si dhe të çdo subjekti tjetër që hyn në marrëdhënie me Federatën, bazuar në zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi, realizimin e objektivave dhe rritjen e performacës së saj.

Neni 2. Objekti i Rregullores

Objekt i kësaj rregulloreje janë:

- a) Struktura, drejtimi dhe veprimtaria e administratës së Federatës;
- b) Marrëdhëniet midis strukturave përbërëse të administratës së Federatës;
- c) Administrimi i akteve që krijohen apo mbërrijnë në Federatë; si dhe
- d) Rregullimi i veprimtarisë së anëtarëve të saj.

ORGANET E FEDERATËS

Neni 3. Struktura Organizative

3.1 Në zbatim të Nenit 11 të Statutit, struktura organizative e Federatës përbëhet nga këto organe:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Presidenti;
- c) Komiteti Drejtues;
- d) Komisione të Veçanta si:
 - Komisioni Teknik;
 - Komisioni i Disiplinës;
 - Komisioni i Gjyqtarëve;
 - Komisioni i Financës; si dhe
 - Komisioni i Organizimit të Garave.

3.2 Komiteti Drejtues mund të krijojë komisione të tjera apo mund të shkrijë një nga komisionet e mësipërme në varësi të nevojave të Federatës.

3.3 Çdo anëtar i federatës që përmbush kriteret e përcaktuara nga Statuti, Rregullorja e Përgjithshme, kriteret e përcaktuara nga Komiteti Drejtues, apo nga rregulloret e brendshme të komisioneve të ndryshme mund të jetë anëtar i një komisioni.

3.4 Anëtarët e Federatës mund të jenë anëtarë të më shumë se sa një komisioni.

3.5 Kryetarët e komisioneve përzgjidhen dhe emërohen me një mandat katër vjeçar nga Komiteti Drejtues në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe propozimeve të anëtarëve të Federatës. Ata gjithashtu shkarkohen dhe ndryshohen nga Komiteti Drejtues.

3.6 Kryetarët e çdo komisioni kanë të drejtë t'i propozojnë anëtarët e komisioneve të tyre përkatës, të cilët miratohen nga Komiteti Drejtues.

Neni 4. Komisioni Teknik

4.1 Përbërja. Komisioni Teknik përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarë. Numri i anëtarëve mund të ndryshojë me vendim të Komiteti Drejtues. Komisioni Teknik duhet të synojë që të ketë në anëtarësinë e tij përfaqësues të të gjitha stileve të Karatesë. Anëtarët e Komisionit Teknik mund të vetëzgjedhin një nënkryetar dhe një sekretar të Komisionit.

4.2 Funksionet: Komisioni Teknik përdor vulën dhe logon zyrtare të miratuar nga Komiteti Drejtues si dhe ka tagrin e veçantë të përdorë simbolet e FSHK-së në përmbushje të dokumentacionit të aktiviteteve dhe veprimtarisë së këtij Komisioni. Ai kryen këto funksione kryesore:

- a) Shërben në rritjen e nivelit teknik të Karatesë në përputhje me strategjinë kombëtare të sportit si dhe atë të federatave ndërkombëtare ku Federata aderon.
- b) Kryen hulumtime dhe studime për zhvillimin e metodave dhe teknikave të stërvitjes të karatesë;
- c) Në bashkëpunim me Komisionin e Organizimit të Garave dhe aprovimin e Komitetit Drejtues harton dhe ndryshon rregullat për zhvillimin e Kampionatit Kombëtar, Kupës së Republikës si dhe garave të tjera, në përputhje me rregulloret e federatave ndërkombëtare ku Federata aderon;
- d) I propozon për miratim Komitetit Drejtues kalendarin vjetor të aktiviteteve kombëtare në përputhje dhe me kalendarin e aktiviteteve ndërkombëtare ku Federata aderon.
- e) Në përputhje me rregulloret ndërkombëtare ku Federata aderon dhe me aprovimin e Komitetit Drejtues, harton dhe ndryshon rregulloren teknike të testeve dhe vendos standardet që duhen plotësuar për breza (kyu dhe dan) në Karate për të gjitha stilet.

- f) Zhvillon testimet për breza (kyu dhe dan) në Karate për të gjitha stilet duke caktuar pjesëmarrësit e komisioneve përkatëse, si i vetmi institucion i Federatës që e ka këtë tagër. Plotëson, mirëmban, përditëson dhe publikon listën e testeve të kryera, sportistëve të kualifikuar dhe rezultateve të tyre.
- g) Mbikqyr dhe ndjek veprimtarinë e sportistëve më të talentuar të Karatesë dhe ndihmon në ngritjen profesionale të tyre.
- h) Harton kriteret për përzgjedhjen e sportistit apo sportistëve më të mirë të vitit si dhe i propozon Komitetit Drejtues listën vjetore të këtyre sportistëve.
- i) Harton kriteret e përfaqësimit të sportistëve në veprimtaritë ndërkombëtare.
- j) Harton dhe i propozon Komitetit Drejtues listën e sportistëve dhe trajnerëve-pjesëmarrës në aktivitetet ndërkombëtare, mbi bazën e kriterëve dhe normave të përfaqësimit në veprimtaritë ndërkombëtare.
- k) I propozon Komitetit Drejtues specialistët të cilët do të dërgohen për seminare kualifikimi pranë organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare të karatesë kryesisht aty ku Federata është anëtare;
- l) I propozon Komitetit Drejtues të Federatës dhënien e Titujve të Lartë (Brezin e Zi mbi 4-Dan), titullin “Mjeshtër Sporti” për specialistët, trajnerët dhe sportistët.

4.3 Kriteret e Përzgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit Teknik.

- a) Përpara përzgjedhjes dhe emërimit të Kryetarit të Komisionit Teknik, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë si më poshtë:
 - Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës për më shumë se sa pesë (5) vjet;
 - Të ketë moshën mbi 30 vjeç;
 - Të jetë specialist i sportit të karatesë dhe ose (i) të jetë i diplomuar nga Universiteti i Lartë i Sporteve (apo ekuivalent i tij) dhe të ketë të paktën brezin e zi 3 Dan (sandan) në Karate, ose (ii) të ketë arsim të lartë si dhe kualifikimin profesional në Karate të dhënë nga Federata Botërore e Karatesë (WKF) të nivelit të paktën katër (4) Dan;
 - Të ketë figurë të pastër morale;
 - Të mos jetë dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
 - Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

Komiteti Drejtues përzgjedh kandidatin që përmbush me mirë kriteret e mesiperme.

- b) Përpara përzgjedhjes të anëtarëve të Komisionit Teknik, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për anëtarë të Komisionit Teknik dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:
 - Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës;
 - Të ketë moshën mbi 25 vjeç;
 - Të jetë specialist i sportit të karatesë dhe të ketë të paktën brezin e zi;
 - Të ketë figurë të pastër morale;
 - Të mos jetë dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe

- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.
- c) Nga lista e me emrat e propozuar nga anëtarët e Federatës, Kryetari i Komisionit Teknik përzgjedh kandidaturat për anëtar të Komisionit Teknik dhe ja propozon për miratim ato Komitetit Drejtues. Komiteti Drejtues përzgjedh kandidatin që përmbush me mire kriteret e mesiperme.

Neni 5. Komisioni i Disiplinës

5.1 Përbërja. Komisioni i Disiplinës përbëhet nga Kryetari dhe dy (2) anëtarë. Numri i anëtarëve mund të ndryshojë me vendim të Komitetit Drejtues.

5.2 Funksionet. Komisioni i disiplinës kryen këto funksione:

- a) Ai është organi i analizimit dhe gjykimit të sjelljeve të të gjithë anëtarëve të anëtarësuar në FSHK, zbatimin e Rregullores së Disiplinës gjatë veprimtarisë zyrtare të sezonit sportiv të Karatesë. Rregullorja e Disiplinës përcakton procedurën dhe masat ndaj të gjithë atyre që çënojnë dhe shkelin rregullat në sportin e karatesë, që shkelin Statutin dhe rregulloret e tjera përkatëse të FSHK-së, atyre që çënojnë prestigjin e sportit të karatesë në mënyra të ndryshme, duke nënkuptuar dhe prezantimin brenda dhe jashtë vendit.
- b) Komisioni i Disiplinës ka tagrin të marrë të gjitha masat disiplinore për çdo anëtar të FSHK-së, përveç pezullimit të anëtarëve që është kopetencë e Komitetit Drejtues dhe përjashtimit të tyre që është kompetencë e Asamblesë.
- c) Vendimet e Komisionit të Disiplinës duhet t'i paraqiten Komitetit Drejtues të FSHK-së brenda tre (3) ditëve nga vendimarrja.

5.3 Kriteret e Përzgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit të Disiplinës

- a) Përpara përzgjedhjes dhe emërimit të Kryetarit të Komisionit të Disiplinës, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë si më poshtë:
 - Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës për më shumë se sa pesë vjet;
 - Të ketë moshën mbi 35 vjeç;
 - Të njohë sportin e karatesë;
 - Të ketë arsim të lartë me preferencë në degën juridik dhe të njohë mirë Statutin, Rregulloren e Brendshme dhe rregulloret e tjera të Federatës si dhe të federatave ndërkombëtare ku Federata aderon;
 - Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
 - Të ketë figurë të pastër morale;
 - Të mos jetë dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
 - Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

Komiteti Drejtues përzgjedh kandidatin që përmbush më mirë kriteret e mesiperme.

b) Përpara përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Disiplinës, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për anëtarë të Komisionit të Disiplinës dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:

- Të jenë anëtar me të drejta të plota të Federatës;
- Të kenë moshën mbi 30 vjeç;
- Të njohin sportin e karatesë;
- Të kenë arsim të lartë dhe të njohin mirë Statutin, Rregulloren e Brendshme dhe rregulloret e tjera të Federatës si dhe të federatave ndërkombëtare ku Federata aderon;
- Të jenë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
- Të kenë figurë të pastër morale;
- Të mos jetë dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

c) Nga lista me emrat e propozuar nga anëtarët e Federatës, Kryetari i Komisionit të Disiplinës përzgjedh kandidaturat për anëtar të Komisionit të Disiplinës dhe ja propozon për miratim ato Komitetit Drejtues.

Neni 6. Komisioni i Gjyqtarisë

6.1 Përbërja. Komisioni i Gjyqtarisë përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarë. Numri i anëtarëve mund të ndryshojë me vendim të Komitetit Drejtues. Anëtarët e Komisionit të Gjyqtarisë mund të vetëzgjedhin një nënkryetar dhe një sekretar të Komisionit.

6.2 Funksioni. Komisioni Gjyqtarisë ka këto funksione;

- a) Komisioni i Gjyqtarisë shërben për drejtimin e veprimtarisë së gjyqtarëve të Federatës, rritjen profesionale të tyre, si dhe mbarëvatjen e gjykimit të aktiviteteve sportive të organizuara nga Federata;
- b) Cakton gjyqtarët që marrin pjesë në aktivitetet sportive, të cilët duhet të jenë të pajisur me librezën e anëtarësisë të FSHK-së dhe licensën kombëtare ose ndërkombëtare. Në organizimin dhe zhvillimin e Kampionateve Kombëtare, Kupës së Republikës dhe atij Mbarëkombëtar, Komisioni i Gjyqtarisë do të bëjë maksimumin e mundshëm brenda fondeve të FSHK-së që të përzgjedhë gjyqtarë që janë të çertifikuar nga WKF, EKF, FBK apo federata të tjera ndërkombëtare ku FSHK aderon.
- c) Kryen testimet për kualifikimin e gjyqtarëve dhe jep çertifikatat dhe diplomat përkatëse që i japin gjyqtarëve të drejtën e gjykimit në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare
- d) Harton dokumentat dhe rregulloret që rregullojnë aktivitetin e Komisionit të Gjyqtarëve si dhe gjyqtarëve anëtarë të Federatës.

6.3 Kriteret e Përzgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit të Gjyqtarisë.

- a) Përpara përzgjedhjes dhe emërimit të Kryetarit të Komisionit të Gjyqtarisë, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë si më poshtë:
 - Të jetë anëtar me të drejta të plota të Federatës për më shumë se sa pesë (5) vjet;

- Të ketë moshën mbi 30 vjeç;
- Të jetë specialist i sportit të Karatesë me nivelin minimal shodan;
- Të ketë kryer kursin e kualifikimit dhe të jetë pajisur me licensë ndërkombëtare nga federatat ndërkombëtare të Karatesë ku Federata aderon;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Nuk është dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

Komiteti Drejtues perzgjedh kandidatin qe permbush më mirë kriteret e mesiperme.

b) Përpara përzgjedhjes të anëtarëve të Komisionit të Gjyqtarisë, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për anëtarë të Komisionit të Gjyqtarisë dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:

- Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës;
- Të jetë specialist i sportit të Karatesë me nivelin minimal shodan;
- Të ketë kryer kursin e kualifikimit dhe të jetë pajisur me licensë kombëtare apo ndërkombëtare nga federatat ndërkombëtare të Karatesë ku Federata aderon;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Nuk është dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

c) Nga lista me emrat e propozuar nga anëtarët e Federatës, Kryetari i Komisionit të Gjyqtarisë përzgjedh kandidaturat për anëtar të Komisionit të Gjyqtarisë dhe ja propozon për miratim ato Komitetit Drejtues.

Neni 7. Komisioni i Financës

7.1 Përbërja. Komisioni i Financës përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarë. Numri i anëtarëve mund të ndryshojë me vendim të Komitetit Drejtues. Anëtarët e Komisionit të Financës mund të vetëzgjedin një nënkryetar dhe një sekretar të Komisionit.

7.2 Funksioni. Komisioni Financës ka këto funksione:

- a) Komisioni i Financës shërben për monitorimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit financiar të FSHK-së;
- b) Aprovon raportin financiar të vitit përpara paraqitjes së tij para Komitetit Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme.

7.3 Kriteret e Përzgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit të Financës.

a) Përpara zgjedhjes së Kryetarit të Komisionit të Financës, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:

- Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës për më shumë se sa pesë (5) vjet;

- Të ketë moshën mbi 35 vjeç;
- Të jetë të paktën njohës dhe dashamirës i sportit të Karatesë;
- Të ketë kryer arsimin e lartë mundësisht në degën financë apo kontabilitet dhe/ose të ketë eksperiencë në këtë fushë;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Të mos jetë dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

Komiteti Drejtues perzgjedh kandidatin qe permbush më mirë kriteret e mesiperme.

b) Përpara përzgjedhjes të anëtarëve të Komisionit të Financës, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për anëtarë të Komisionit të Financës dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:

- Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës;
- Të jetë të paktën njohës dhe dashamirës i sportit të Karatesë;
- Të ketë arsimin e lartë;
- Nuk është dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

- c) Nga lista me emrat e propozuar nga anëtarët e Federatës, Kryetari i Komisionit të Financës përzgjedh kandidaturat për anëtar të Komisionit të Financës dhe ja propozon për miratim ato Komitetit Drejtues.

Neni 8. Komisioni i Organizimit të Garave

8.1 Përbërja. Komisioni i Garave përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarë. Numri i anëtarëve mund të ndryshojë me vendim të Komitetit Drejtues. Anëtarët e Komisionit Teknik mund të vetëzgjedin një nënkryetar dhe një sekretar të Komisionit.

8.2 Funksionet. Komisioni i Garave ka këto funksione kryesore:

- a) Organizon aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë në sportin e Karatesë.
- b) Përgatit ambientin e brendshëm në sallë dhe përcakton zonën e sigurisë për zhvillimin sa më normal të garës në përputhje me rregulloren ndërkombëtare.
- c) Bashkëpunon me Shoqatat Sportive për organizimin e veprimtarive të Karatesë në rang lokal, kombëtar e ndërkombëtar, që zhvillohen në rrethe dhe qytetet e tyre.
- d) Përpilon buletin zyrtar të aktiviteteve dhe merr masa për sistemimin e ekipeve sportive në hotele, etj.
- e) Merr masat e duhura për mbarëvajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e rendit në sallën e zhvillimit të veprimtarisë si dhe kontrollon dhe miraton nëse salla plotëson kushtet teknike.
- f) Zbaton programin sipas buletinit të aktivitetit për datat e caktuara si dhe oraret e zhvillimit të garave për të gjitha moshat dhe peshat që marrin pjesë në veprimtari.
- g) Është përgjegjës direkt për procesin e regjistrimit të sportistëve në gara si dhe për hedhjen e shortit dhe përgatitjen e protokolleve zyrtare të ndeshjeve.
- h) Dorëzon shortet dhe të gjitha materialet e nevojshme Komisionit të Gjygtarëve dhe sekretarëve të garave përpara fillimit të zhvillimit të ndeshjeve. Procesi i zhvillimit teknik të garave (ndeshjeve) është kompetencë e Komisionit të Gjygtarëve.
- i) Organizon ceremoninë e hapjes të aktivitetit sipas programit të përcaktuar në buletin zyrtar si dhe ceremoninë e ndarjes së medaljeve të fituesve.
- j) Paraqet dhe dokumenton shpenzimet financiare të cilat u përdorën për organizimin e aktivitetit.
- k) Përgatit dhe ruan të gjitha materialet e aktivitetit si dhe shpall zyrtarisht rezultatin përfundimtar. Materialet duhet të dorëzohen në sekretarinë e përgjithshme të FSHK-së brenda 3(tre) ditëve nga përfundimi i aktivitetit.

8.3 Kriteret e Përzgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit të Garave.

- a) Përpara përzgjedhjes dhe emërimit të Kryetarit të Komisionit të Garave, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për Kryetar dhe anëtar të Komisionit të Garave dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:
 - Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës;
 - Të jetë njohës i sportit të Karatesë;

- Të njohë rregulloren e gjyqtarisë dhe rregulloren teknike të garave të miratuara nga Federata dhe federatat ndërkombëtare ku Federata aderon;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Nuk është dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

Komiteti Drejtues përzgjedh kandidatin që përmbush më mirë kriteret e mesiperme.

b) Përpara përzgjedhjes të anëtarëve të Komisionit të Garave, Komiteti Drejtues fton anëtarët e Federatës të dërgojnë kandidaturat e tyre për anëtarë të Komisionit të Garave dhe bën publike kriteret e përzgjedhjes që janë minimalisht si më poshtë:

- Të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës;
- Të jetë njohës i sportit të Karatesë;
- Të njohë rregulloren e gjyqtarisë dhe rregullore teknike të garave të miratuara nga Federata dhe federatat ndërkombëtare ku Federata aderon;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

c) Nga lista me emrat e propozuar nga anëtarët e Federatës, Kryetari i Komisionit të Garave përzgjedh kandidaturat për anëtar të Komisionit të Garave dhe ja propozon për miratim ato Komitetit Drejtues.

ANËTARËSIMET

Neni 9. Anëtarësimi

Në shtesë të kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara nga Statutit, kandidatët që duan të jenë anëtarë të Federatës duhet të paraqisin dokumentacionin si më poshtë:

- a) Dëshmi aftësie që ka drejtuesi i ekipit (diplomën dan) në sportin e Karatesë të marrë nga Federata apo nga federatat anëtare të federatave ndërkombëtare ku Federata aderon; si dhe
- b) Listën me të paktën 5(pesë) sportistë anëtar të shoqatës apo klubit sportiv të cilët stërviten në sportin e karatesë nga ky drejtues, së bashku me fotokopje të kartës së tyre të identitetit apo pashaportës.

Neni 10. Detyrimet e Anëtarëve

10.1 Në shtesë të Nenit 7 të Statutit, anëtarët e Federatës kanë këto detyrime:

- a) Të marrin pjesë detyrimisht në Kampionatet Kombëtare, Kupën e Republikës dhe Kampionatin Mbarëkombëtar të organizuar nga Federata. Anëtarët provizor të

Federatës dhe/ose anëtarët e rinj përjashtohen nga detyrimi i mësipërm për vitin e parë të anëtarësimit me të drejta të plota.

- b) Anëtarët inkurajohen, por nuk janë të detyruar, të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e tjera të organizuara apo aprovuara nga Federata.
- c) Të kenë të licensuar të paktën 5(pesë) sportistë pranë Federatës për çdo vit kalendarik.
- d) Të gjithë anëtarëve të FSHK-së, ju ndaloheq që, në mënyrë direkte ose indirekte, të organizojnë, ndihmojnë në organizimin apo marrin pjesë në veprimtari brenda Shqipërisë që lidhen me sportin e Karatesë te cilat nuk janë organizuar apo te cilat nuk kanë marrë miratimin e Federatës për zhvillimin e tyre.
- e) Të gjithë anëtarëve të FSHK-së, ju ndaloheq që, në mënyrë direkte ose indirekte, të organizojnë, ndihmojnë në organizimin apo marrin pjesë në veprimtari jashtë Shqipërisë që lidhen me sportin e Karatesë të cilat nuk janë organizuar apo të cilat nuk kanë marrë miratimin e federatave të vendit ku organizohen apo miratimin e federatave ndërkombëtare ku Federata aderon.
- f) Statusi anëtar i FSHK-së e detyron anëtarin të paguajë një kuotë licensimi vjetor në lekë, për të gjithë sportistët dhe trajnerët e shoqatës së tij. Kuota e licensimit vjetor përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të FSHK-së. Afati përfundimtar i licensimeve në një vit përcaktohet në Asamblenë e Përgjithshme të FSHK-së ose me vendim të Komitetit Drejtues të FSHK-së. Licensime mund të kryhen edhe gjatë vitit për anëtarët e rinj që anëtarësohen për herë të parë në FSHK.

10.2 Anëtarët e Federatës që nuk zbatojmë detyrimet e përcaktuara më lart do jenë subjekt i procedurave disiplinore nga Komisioni i Disiplinës.

Neni 11. Libreza e Anëtarit

11.1 FSHK është e detyruar në bazë të statutit, të pajisë të gjithë anëtarët e saj me librezë anëtarësie.

11.2 Kosto dhe modeli i librezës anëtarësisë përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues të FSHK-së.

11.3 Të gjithë anëtarët e FSHK janë të detyruar të pajisen me librezën e anëtarësisë në momentin e regjistrimit të tyre në FSHK.

11.4 Në librezën e anëtarësisë duhet të jenë të dhënat personale (foto, emër mbiemër, datëlindja, klubi, grada në karate, çertifikimi mjekësor, etj.)

11.5 Pajisja me librezë anëtarësie bëhet për të gjithë sportistët dhe praktikuesit e rinj të çdo ekipi në fillimin e vitit së bashku me pagesën e licensimit vjetor ose dhe gjatë vitit për sportistët fillestar që regjistrohen për herë të parë në sportin e karatesë.

11.6 Libreza e anëtarësisë duhet të paraqitet nga çdo sportist pjesëmarrjës në garat kombëtare.

11.7 FSHK gëzon të drejtën të pajisë me libreza dhe diploma ndërkombëtare nga WKF, anëtarët e saj të cilët përmbushin kushtet e parashtruara në rregulloren e Word Karate Federation.

Neni 12. Transferimet

Sportistët dhe trajnerët anëtarë të FSHK, kanë të drejtë të lëvizin nga një Klub (Shoqatë) Sportiv në tjetrën lirshëm e sipas dëshirës. Transferimi me këtë rast bëhet me përfundimin e aktivitetit sportiv Kombëtar (muaji Dhjetor) deri në fund të muajit Janar të vitit pasardhës. Sportistët e licensuar pranë nje Klubi/Shoqate sportive nuk mund te transferohen në një Klub/Shoqatë tjetër sportive pa u mbyllur viti kalendarik, pa marrëveshjen e klubit/shoqatës së origjinës dhe Komisionit Teknik të Federatës. Sportistë që nuk zbatojnë këto rregulla nuk lejohen të marrin pjesë në aktivitet e organizuara apo miratuara nga Federata.

EKIPET KOMBËTARE

Sportistët e ekipeve kombëtare propozohen nga Komisioni Teknik dhe miratohen nga Komiteti Drejtues. Komisioni Teknik ngarkohet të hartojë rregullore të detajuara të përcaktimit të kritereve të përzgjedhjes së ekipeve kombëtare, të bazuara në parimet bazë si më poshtë:

Neni 13. Kriteret e Përcaktimit të Trajnerëve të Ekipit Kombëtar

13.1 Trajnerët e ekipeve kombëtare për grup moshat e ndryshme përzgjidhen nga Komiteti Drejtues nga ata kandidatë që plotësojnë sa më mirë kriteret e mëposhtme:

- a) Është trajner fitues i Kampionatit Kombëtar dhe ka më shumë sportistë anëtar të ekipit kombëtar në atë lloj veprimtarie ndërkombëtare.
- b) Kanë diplomë të kualifikimit profesional dhënë nga Federata Botërore e Karatesë (WKF “Accredited Coach”).
- c) Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e organizuara, Seminare, Trajnime, Kampionate Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- d) Ka kategorinë mbi 3-DAN të dhënë nga WKF, FSHK ose nga federata të tjera që janë anëtare të federatave ndërkombëtare ku Federata aderon.
- e) Ka nxjerrë Kampionë Kombëtar ndër vite.
- f) Ka qenë sportist cilësor, medalist në veprimtaritë ndërkombëtare dhe Kampion Kombëtar në peshën e tij.
- g) Ka të licencuar pranë Federatës, stërvit dhe merr pjesë në veprimtaritë Kombëtare me mbi 10 sportistë të moshave të ndryshme.
- h) Ka dhënë ndihmesë me literaturë ose ka drejtuar seminare në ngritjen profesionale të trajnerëve të tjerë;
- i) Ka moshë mbi 30 vjeç (sidomos për ekipin e të rriturve).
- j) Njeh gjuhën angleze.
- k) Është anëtar i Federatës Shqiptare të Karatesë;
- l) Ka figurë të pastër morale;
- m) Nuk është dënuar ndonjëherë nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj; si dhe
- n) Të mos jetë i dënuar nga organet drejtuese të Federatës.

13.2 Trajneri i Ekipit Kombëtar nuk mund të jetë trainer dhe sportist në të njëjtin aktivitet sportiv.

Neni 14. Përzgjedhja e Trajnerëve

14.1 Trajnerë të parë të ekipit kombëtar do të përzgjidhet ata trajnerë që përmbushin më mirë kriteret e mësipërme. Cdo trajner i parë i ekipit kombëtar përzgjidhet për një mandat 4-vjeçar.

14.2 Në rastet kur ekipi kombëtar merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare me më shumë se 5 sportistë, ekipi do të ketë nevojë për më shumë se 1 trajner (referuar rregullores ndërkombëtare e cila përcakton në çdo 5 sportistë duhet të jetë 1 trajner).

14.3 Trajnerët e dytë do të përcaktohen çdo vit sipas kësaj renditje.

- a) Trajneri fitues i vendit të 1-rë në Kampionatin Kombëtar (i cili me ekipin e tij fiton Kampionatin Kombëtar në kategorinë përkatëse për Fëmijë, Kadet, Junior dhe Senior);
- b) Trajneri fitues i vendit të 2-të në Kampionatin Kombëtar;
- c) Trajneri fitues i vendit të 3-të në Kampionatin Kombëtar;
- d) Trajner i përzgjedhur nga Komisioni Teknik i FSHK-së;

14.4 Në rast se një sportist i kombëtares fiton medalje në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe për këto gje caktohet shpërblim nga FSHK apo institucione të tjera për sportistin dhe trajnerin, shpërblimi do të ndahet trajnerit të drejtpërdrejtë të sportistit (dhe jo trajnerit të parë të kombëtares, përveç rastit kur trajneri i parë i kombëtares është gjithashtu trajner i drejtpërdrejtë i sportistit fitues).

Neni 15. Detyrat e Trajnerit të Ekipit Kombëtar

15.1 Trajnerët i ekipit kombëtar kryen këto funksione:

- a) Harton një plan 4 vjeçar për zhvillimin e cilësisë sportive të anëtarëve të ekipit kombëtar, me qëllim final përfaqësimin e suksesshëm të Shqipërisë në kampionatet ndërkombëtare si dhe olimpiadë. Ja paraqit këtë plan për miratim Komisionit Teknik dhe Komitetit Drejtues.
- b) Përfaqëson Shqipërinë me dinjitet në të gjitha takimet ndërkombëtare ku ajo merr pjesë.
- c) Përzgjedh dhe grumbullon ekipin kombëtar si dhe kandidatët e mundshëm për anëtar të ekipit kombëtar përpara aktiviteteve ndërkombëtare sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe dokumenta të tjera të aprovuar nga Komiteti Drejtues.
- d) Organizon grumbullime të sportistëve të ekipit kombëtar për të rritur nivelin sportiv të tyre.

Neni 16. Kriteret e Sportistëve të Ekipit Kombëtar

16.1 Kriteret për përzgjedhjen e sportistëve të ekipit kombëtar janë si vijon, por pa u kufizuar vetëm në to:

- a) Sportisti që ka fituar medalje në nivel ndërkombëtar në atë lloj veprimtarie (Kampionate Ballkanike, Mesdhetare, Europiane apo Botërore) brenda vitit ose një vit më parë.
- b) Sportisti që shpallet Kampion Kombëtar për moshën dhe peshën e tij.
- c) Sportisti që ka progres dhe stabilitet në garat e zhvilluara gjatë vitit.
- d) Sportisti që në garën e kontrollit para veprimtarisë ndërkombëtare, ka gjendje të mirë sportive.
- e) Sportisti që eskperiençë dhe ta njeh mirë sportin e Karatesë dhe rregulloren e arbitrimit.
- f) Sportisti që ka më shumë gjasa të sigurojë medalje në kategorinë e tij.
- g) Sportisti i ri me shumë perspektivë.

16.2 Sportistët detyrimisht duhet të jenë anëtarë të Federatës Shqiptare të Karatesë, të kenë paguar kuotizacionin dhe nuk duhet të kenë shfaqje antisportive apo të jenë duke vuajtur dënime të marra më parë nga organet e FSHK-së.

Neni 17. Masa e Përfitimit Ditor dhe Shpërblimet

17.1 Nëse mund të përballohen nga buxheti i Federatës, shpërblimet për rezultatet e mira në gara si dhe nivelet e masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor që financohen nga FSHK për sportistë të kategorisë së parë përcaktohen me Vendim të Komitetit Drejtues të FSHK-së në bazë të ligjeve në fuqi.

AKTET ADMINISTRATIVE

Neni 18. Aktet Administrative

18.1 Aktet Administrative (vendime, urdhëra, informacione, shkresa) janë ato akte që nxirren nga strukturat përkatëse në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të FSHK-së dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit të saj.

18.2 Propozimi dhe marrja e vendimeve bëhet nga Komiteti Drejtues i FSHK-së ku jepen shpjegime për motivet e nxjerrjes së vendimit. Bazën ligjore të tij e kontrollon Sekretari Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm e përgatit dhe paraqet atë tek anëtarët e FSHK-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij vendimi.

18.3 Dokumenti që mban vendimin nënshkruhet personalisht nga anëtarët prezent të Komitetit Drejtues. Sekretari i Përgjithshëm ka për detyrë shpërndarjen dhe publikimin e dokumentit, dorazi me postë ose në mënyrë elektronike me e-mail, duke mbajtur një kopje për arkivën dhe protokollin.

Neni 19. Nënshkrimi

19.1 I gjithë dokumentacioni shkresor, ku përfshihen (vendime, urdhëra, udhëzime), korrespondenca (shkresat) për përdorim të brendshëm apo që destinohen për jashtë FSHK-së nënshkruhen nga Presidenti i FSHK-së ose Sekretari Përgjithshëm.

19.2 Shkresat përcjellesë të vendimeve nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm.

19.3 Delegimi i kompetencave duhet të bëhet me shkrim. Në rastet e delegimit duhet bërë shënimi “në mungesë dhe me autorizim” duke vendosur emrin e të autorizuarit.

19.4 Nuk mund të delegohen kompetencat dhe të firmosen në mungesë të Presidentit attribute ligjore që i njihen vetëm këtij të fundit.

19.5 Presidenti mund të autorizojë një përfaqësues të FSHK-së i cili ka të drejtën e firmës për të bërë veprimet financiare në emër të FSHK-së. Kjo firmë do të depozitohet pranë institucioneve financiare të përcaktuara me ligj.

19.6 Shkresat që qarkullojnë brenda federatës duhet të jetë me logon e FSHK-së, të mbajë datë, numër protokollit dhe të firmoset dhe vuloset zyrtarisht nga Sekretari i Përgjithshëm ose nga Presidenti.

Neni 20. Vula

20.1 Federata Shqiptare e Karatesë ka vulën zyrtare, e cila është përcaktuar në statutin e FSHK-së dhe identifikon institucionin në dokumentet e nxjerra prej tij.

20.2 Vula zyrtare mbahet dhe përdoret nga Sekretari Përgjithshëm dhe Presidenti FSHK.

20.3 Vula përdoret për dokumente që kanë datë, numër protokollit dhe janë të firmosura nga Presidenti ose Sekretari Përgjithshëm si dhe për dokumenta të tjerë zyrtarë të FSHK-së.

20.4 Asnjë person nuk mund të përdorë në dokumenta vulën dhe simbolet e FSHK pa marrë paraprakisht miratimin zyrtar nga Komiteti Drejtues i FSHK-së firmosur nga Presidenti.

Neni 21. Vërtetime dhe Dokumenta nga FSHK

21.1 Të gjithë trajnerët, sportistët dhe anëtarët e FSHK të cilët duan të pajisen me vërtetim nga ana e FSHK-së, duhet të paguajnë një kosto për shërbim administrativ prej 200 lekë për çdo vërtetim.

21.2 Kjo shumë paguhet në sekretari me mandate pagese apo në llogarinë e FSHK-së dhe kjo shumë shkon për llogari të FSHK-së. Administrimi dhe mbajtja e shumës së përfituar nga ky veprim duke e evidentuar në librat e llogarisë si burim nga të ardhurat dytësore është detyrë e përgjegjëses së financës. Vërtetimi duhet të mbajë numër protokollit të firmoset dhe vuloset zyrtarisht nga Sekretari i Përgjithshëm dhe një kopje e tij do të qëndrojë në dosjen e dokumentave në FSHK.

21.3 Vërtetim jepet me pagesë për këto raste:

- a) Vërtetim për qënien anëtar i FSHK-së;
- b) Për të vërtetuar kualifikimin e trajnerit si dhe gradën e tij bazuar në dokumentat përkatëse;
- c) Për të vërtetuar titujt e fituar nga një sportist, klub apo shoqatë sportive bazuar në dokumentat përkatëse.

21.4 Vërtetim jepet pa pagesë për këto raste:

- a) Vërtetim për kryerjen e licensimit vjetor në FSHK;
- b) Për të justifikuar mungesa në punë ose shkollë për sportistët dhe trajnerët e ekipit kombëtar që kanë marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare si dhe kërkesë për marrje pjesë në to;
- c) Vërtetimi për kryerjen e pagesës në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22. Interpretimi

Komiteti Drejtues i FSHK-së është i autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 23. Shfuqizim

Rregullorja e Brendshme e FSHK-së, e miratuar me vendimin Nr.1, datë 17.12.2000 “Rregullore e Brendshme e Federatës Shqiptare të Karatesë”, shfuqizohet.

Neni 24. Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më menjëherë.

(Vula e FSHK-së)